

Titulli i lëndës: MITOLOGJIA DHE LETËRSIA

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Mitologjia dhe Letërsia
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	Viti i katërt Semestri i tetë
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa 78
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Osman Gashi
Të dhënat kontaktuese:	+383 44 174 174 // osman.gashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi “Mitologjia dhe Letërsia” do të merret me dy çështje themelore: me mitin si fenomen të pandashëm të të gjitha shoqërive dhe të të gjitha kulturave si dhe me letërsinë, me natyrën dhe me funksionin e saj. Do të trajtojë në mënyrë të veçantë historinë, filozofinë e prejardhjen e mitit si dhe natyrën e ligjësitë e brendshme të tij.</p> <p>Duke qenë se miti është i pandashëm nga format narrative, nga zhanret e llojet letrare, do të flitet edhe për funksionalizimin e transformimin e tij në domenin e letërsisë. Do të kihet parasysh arketipet, simbolet, format e ndryshme narrative, të cilat studiuesit i quajnë mitopoetike apo madje edhe letërsi neomitike.</p> <p>Do të bëhet një përvijim historik i letërsisë shqipe si dhe i asaj botërore, ku miti është në esencën e saj dhe e pasuron esencialisht atë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi themelor i lëndës është që të njohë studentët me konceptet dhe postulatet themelore të disiplinës së Mitologjisë si dhe me interrelacionin e saj me letërsinë. Duke qenë se kjo fushë është interdisiplinare, po kështu, studentët do të fitojnë njohuri të gjera mbi shumë fusha tjera të dijes dhe raportet e tyre me artin letrar si: Filozofia, Psikologjia, Sociologjia, Piktura... Gjithashtu do të bëhet përpjekje që studentët individualisht apo në grupe të hulumtojnë vetë dukuri, vepra e autorë të letërsisë shqipe e botërore në kontekstin e relacioneve me mitin.</p>

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Gjatë zhvillimit të ligjëratave, ushtrimeve e konsultimeve si dhe në përfundim të kursit studentët do të kenë mundësinë: - Të fitojnë informacione dhe të demonstrojnë njohuri për mitologjinë klasike; - Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike – analitike e krahasimtare; - Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko – letrare
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime kollokuime, teste, punë në grupe, shkrime esesh
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50 %. Vijueshmëria e studentit 10 %; Detyrat individuale të kryera në klasë 10 %; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10 %; Vlerësimi nga testet 20 %; Provimi final 50 %.
Literatura primare:	Todi Dhama: Fjalori i mitologjisë, ; Voçeh Zamarovski: Heronjtë e miteve antike; Prishtinë, 1988; Azem Qazimi: Fjalori I mitologjisë dhe demonologjisë shqiptare, Plejad, Tiranë, 2008; Osman Gashi: Kufijtë e letërsisë, Prishtinë, 2008; Osman Gashi: Letërsia dhe miti, Prishtinë, 2014.
Literatura shtesë:	Epi i Gilgameshit, Homeri: Iliada dhe Odiseja; Hesiodi: Punët dhe ditët, Teogonia; Eskili: Prometheu i lidhur, Sofokliu, Mbreti Edip, Euripidi: Medeja, Aristofani: Bretkosat; Virgjili: Eneida; Dante Aligieri: Ferri; J. W. Gëte: Fausti, P. B. Shelli: Prometheu i çliruar;

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Mitet dhe mitologjia – konceptet themelore, domethënia, kartakteri dhe objekti i studimit; Studimet e studiuesit e mitit
Java 2:	Mitogonia – krijimi i miteve
Java 3:	Historia dhe miti; Aspekti interdisiplinar; Shtrirja, konteksti social e historik
Java 4:	Oraliteti, folklori; Relacioni i mitit me format tjera narrative (fabula, gojëdhana, legjenda, përralla, saga, rrëfimet etiologjike)
Java 5:	Llojet e interpretimeve mbi mitologjinë (alegorike, romantike, comparative, folklorike, strukturaliste, formaliste)

Java 6:	Miti dhe fushat tjera të dijes (psikologjia, religjioni, filozofia, arti)
Java 7:	Llojet e miteve (mitet mbi origjinën, mitet eshatologjike dhe destruksioniste, mitet mesianike dhe milenarike)
Java 8:	Llojet e miteve II (mitet mbi heronjtë kulturorë, mitet soteriologjike, mitet për kohën dhe eternitetin)
Java 9:	Llojet e miteve III (mitet mbi providencën dhe destinimin, mitet mbi Rilindjen dhe Ripërtërirjen, mitet e kujtesës e të harreses)
Java 10:	Mitologjia klasike (mitologjia e lashtë greke); Sistemi i miteve olimpike
Java 11:	Miti grek dhe letërsia greke (Homeri, Hesiodi, tragjedia, komedia, poezia lirike)
Java 12:	Mitologjia klasike (mitet romake dhe mitet e popujve tjerë) Lashtësia, Antikiteti, Mesjeta) Renesanca, Klasicizmi, Iluminizmi, Romantizmi, Realizmi, Modernizmi e Postmodernizmi
Java 13:	Miti dhe letërsia shqipe Letërsia e vjetër, Romantizmi, vitet 30-të, letërsia pas 1945-tës Autorë, vepra, tema, dukuri, arketipe
Java 14:	Mitet në shoqëritë moderne (sekularizimi dhe demitologjizimi)
Java 15:	Miti dhe e ardhmja

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet e tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet, janë të ndaluara.